

DIJETARI I MADH  
EL ALBANI

KUL-LU  
BID'ATIN

DALALE



Titulli: "Të gjitha bidatet janë humbje"  
Autori: Muhammed Nasiruddin el Albani  
Burimi: Kaseta nr. 202, te kategoria "Mutefer-rikât"  
Përktheu: Blerand Grubi



© essunneh.com  
1442H - 2020



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
Bismil-lâhir-Rahmânir-Rahîm

I gjithë lavdi me falënderim i përket All-llahut! Prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje. Atij i kërkojmë strehim e mbrojtje nga sherri i vetëve tona dhe nga punët tona të këqija. Atë që e udhëzon All-llahu nuk ka kush e humb dhe atë që e humb All-llahu nuk ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar të drejtë veç All-llahut, i Cili është Një e i pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

**“O besimtarë! Kijeni frikë All-llahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë muslimanë!”** [Âl ‘Imrân, 102]

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً  
وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

**“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Frikësojuni All-llahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, All-llahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”** [En-Nisâ, 1]

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا (70) يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ  
وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا (71)

**“O besimtarë, frikësojuni All-llahut dhe thoni vetëm të vërtetën, Ai do t’jua përmirësojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”** [El-Ahzâb, 71]

Më pas:

Vërtet, fjala më e mirë është Fjala e All-llahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (ﷺ). Ndërsa gjërat më të këqija në fe janë risitë, pasi çdo risi është bidat, çdo bidat është devijim dhe çdo devijim çon në Zjarr!

Më pas:



Nga çështjet, për të cilat nuk ka asnjë kundërshtim në mesin e dijetarëve muslimanë, pa përjashtim, është se Islami është i ngritur mbi dy themele madhështore, mbi dy shtylla të mëdha dhe ato janë:

1. Vetëm All-llahut t'i kushtohet i gjithë adhurimi;
2. Vetëm Profeti Muhamed (ﷺ) të pasohet dhe të merret si shëmbëlltë.

Sa i përket temës “I gjithë adhurimi t'i kushtohet vetëm All-llahut”, atë nuk do ta diskutojmë, sepse, siç thotë shprehja (arabe): *“Kjo është si puna e transportuesit të hurmave për në Hexhër!”* Sepse ju, që të gjithë in-shâAll-llâh, keni njohuri të mjaftueshme dhe s'keni nevojë ta diskutojmë këtë temë madhështore.

Tema, të cilën dua ta diskutojmë tani është baza dhe themeli i dytë: **“Vetëm Profeti Muhamed (ﷺ) të pasohet dhe të merret si shëmbëlltë”**.

Të gjithë ne e dimë, siç e përmenda më herët, se imani i një muslimani nuk plotësohet nëse nuk beson se Muhamedi (ﷺ) është i Dërguar i All-llahut. Dhe e dimë se cilido person në fytyrën e Tokës, edhe nëse dëshmon se All-llahu është Një në të tria aspektet e Njëshmërisë, ai nuk bëhet besimtar deri sa t'ia bashkëngjisë kësaj besimin se Muhamedi është Robi dhe i Dërguari i Tij.

Pasi është kështu, atëherë muslimani, siç është urdhëruar ta mësojë dhe ta njohë kuptimin Fjalës së Bukur ‘Lâ ilâhe il-All-llâh’:

**فاعلم أنه لا إله إلا الله**

**“Dije se nuk ka të adhuruar të drejtë veç All-llahut!”** [Muhammed, 19]

- dhe pasi ta mësojë këtë fjalë dhe ta njohë kuptimin e saj të vërtetë, ai ngarkohet me dy obligime:

- Së pari: ta besojë atë;
- Së dyti: ta zbatojë te vetvetja, te ibadeti dhe te besimi i tij në All-llahun.

Por, siç thashë, ju nuk keni nevojë, in shâAll-llah, për t'i diskutuar hollësitë e kësaj teme. E, kështu njësoj është urdhëruar ta njohë edhe kuptimin e dëshmisë: **“Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij”**, pa të cilën nuk plotësohet dëshmia e parë. Prandaj tani do të flas më gjatë rreth dëshmisë së dytë dhe do të sqaroj se edhe kjo dëshmi nuk mund të plotësohet ndryshe, përveçse pasi muslimani ta besojë atë së pari, me njohje, me iman dhe me bindje të prerë; dhe së dyti ta zbatojë atë te të gjitha hapat dhe përpjekjet e tij, gjatë gjithë jetës së tij.



Njëra prej atyre gjërave që dëshmia jonë: **“Muhamedi është robi dhe i Dërguari i All-llahut”** i nënkupton dhe i kërkon me ngulm është: besimi se Muhamedi (ﷺ) e ka përcjellë Mesazhin dhe e ka kryer Amanetin në mënyrë të plotë e të përsosur, në atë mënyrë që, askujt në të ardhmen, sado që të jetë i lartësuar dhe i ditur, nuk i ka lënë hapësirë për ta korrigjuar, ose zbrazëtirë për ta plotësuar, në cilëndo çështje.

Këtë realitet na e ka treguar Zoti ynë (‘azze ue xhel-le) me Fjalët e Tij:

اليوم أكملت لكم دينكم وأتممت عليكم نعمتي ورضيت لكم الإسلام دينا  
**“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe Jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj.”** [El-Mâide, 3]

Për këtë shkak, Profeti (ﷺ), në një hadith të saktë të përcjellë me rrugë të shumta transmetimi, ka thënë:

“ما تركت شيئا يقربكم إلى الله ويباعدكم عن النار إلا وأمرتكم به. وما تركت شيئا يقربكم إلى النار ويباعدكم عن الله إلا ونهيتمكم عنه.”

*“Nuk kam lënë asnjë gjë prej gjërave që ju afrojnë tek All-llahu e që ju largojnë nga Zjarri pa jua urdhëruar dhe nuk kam lënë asnjë gjë prej gjërave që ju largojnë nga All-llahu e ju afrojnë kah Zjarri pa jua ndaluar.”*

Pra, nuk ka mbetur asnjë hapësirë për plotësim ose korrigjim, sado që të jetë ai korrigjim i lehtë, ose i vogël!

Duke u nisur nga kjo, përcillet se “Imami i Tokës së Hixhretit” – Imam Mâlik ibën Enesi (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

“Ai që shpik në Islam një bidat dhe e konsideron të mirë, me këtë ai pretendon se Muhamedi (ﷺ) e ka tradhtuar Mesazhin! Lexojeni Fjalën e All-llahut (tebârake ue te’âlâ):

اليوم أكملت لكم دينكم وأتممت عليكم نعمتي ورضيت لكم الإسلام دينا  
**“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe Jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj.”** [El-Mâide, 3]

Imam Maliku (All-llahu e mëshiroftë) gjithashtu thotë:

“Nuk mund të rregullohet ky Umet në të ardhmen, përveçse me atë që u rregulla në fillim! Prandaj, diçka që në atë kohë nuk ka qenë e fesë, nuk mund të jetë as sot e fesë!”

Këto fjalë vijnë nga dituria e thellë e imam Malikut – All-llahu e mëshiroftë – ‘Imamit të Medinës’. Ai shprehet prerazi, me gjuhë të qartë arabe, se kush shpik në Islam një risi dhe kujton se ajo është e mirë, ai kështu ka pretenduar se Muhamedi (ﷺ) e ka tradhtuar Mesazhin!



Dhe kushdo që pretendon kështu, i bie që nuk beson se “Muhamedi është robi dhe i Dërguari i All-llahut” – siç kuptohet qartë nga fjalët e këtij imami të madh:

“Ai që shpik në Islam një bidat dhe e konsideron të mirë, me këtë ai pretendon se Muhamedi (ﷺ) e ka tradhtuar Mesazhin! Lexojeni Fjalën e All-llahut (tebârake ue te’âlâ):

اليوم أكملت لكم دينكم وأتممت عليكم نعمتي ورضيت لكم الإسلام دينا

**“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe Jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj.”** [El-Mâide, 3]

“Nuk mund të rregullohet ky Umet...”

Kjo është pjesë e fjalëve të Imam Malikut:

“Nuk mund të rregullohet ky Umet në të ardhmen, përveçse me atë që u rregulla në fillim! Prandaj, diçka që në atë kohë nuk ka qenë e fesë, nuk mund të jetë as sot e fesë!”

**“Sot jua përsosa...”** – domethënë që muslimanit nuk i ka mbetur gjë për detyrë, përveçse ta ndjekë Profetin (ﷺ) realisht – që të dëshmohet se sa, në të vërtetë, beson që Muhamedi është robi dhe i Dërguari i All-llahut dhe sa beson që ai na e ka përcjellë Mesazhin tërësisht dhe e ka përmbushur atë, pa shtuar e pa cinguar gjë.

Meqë kështu është puna, atëherë çdo musliman duhet ta njohë cakun e vet dhe, të çështjet e ibadeteve dhe adhurimeve, të ndalet aty ku Profeti i tij (ﷺ) ia ka caktuar kufijtë. Lapsi është tharë më, pas asaj që është shkruar në Sheriat! Nuk ka mbetur asnjë mundësi që ndonjë ibadet të mund të konsiderohet “i mirë”, nëse nuk ka ekzistuar që në fillim.

Me këtë bindje kanë ecur të parët tanë të mirë (esSelefus-Sâlih) – All-llahu qoftë i kënaqur me ta – të cilët e njihnin mirë pozitën e Profetit (ﷺ). Ata e njihnin pozitën e tij së pari nga aspekti se ai e ka kryer Mesazhin dhe e ka përcjellë amanetin (përgjegjësinë e besuar), siç e kuptuat dhe, së dyti, nga aspekti se ai është njeriu më i devotshëm; njeriu që e ka adhuruar All-llahun më shumë dhe më fort se të gjithë dhe njeriu që i ka pasur frikë All-llahut (azze ue xhel-le) më shumë se të gjithë.

Prandaj, nuk ka asnjë hapësirë për t’u korrigjuar ky njeri; as në aspektin ligjvënës – siç e dëgjuat ajetin, bashkë me komentin e imam Malikut – dhe as në aspektin e pretendimit se mund të ekzistojë dikush më i devotshëm (më ibadetçi) se Profeti i All-llahut (ﷺ). Kjo është një gjë e pamundur.



Kush i kupton këto dy të vërteta, që lidhen me besimin se **‘Muhamedi është Robi dhe i Dërguari i All-llahut’**, do të mjaftohet e do t’i përmbahet vetëm atyre ibadeteve që i ka sjell Profeti (ﷺ) dhe, gjithashtu, nuk do ta vendosë para vetes dikë si shembull, krahas Profetit (ﷺ).

Pra, asnjë besimtari nuk mund t’i shkojë mendja se është më i përlur, më me frikë dhe më i devotshëm ndaj All-llahut se Profeti (ﷺ), sepse kjo është diçka e pamundur. Dhe për të përkrahur këtë fakt, do të përmendim tani hadithin e transmetuar në “Sahihun” e Buharit dhe “Sahihun” e Muslimit me zinxhir të saktë pa dyshim, të cilin e përcjellë Enes ibën Maliku (radijAll-llahu anhu). Në këtë hadith thuhet:

“Një grup erdhi te Profeti (ﷺ), por nuk e gjetën në shtëpi. Atëherë i pyetën gratë e tij për adhurimet që i bënte Profeti (ﷺ); i pyetën për namazin e tij të natës, për agjërimin e tij gjatë ditës dhe për afrimin (marrëdhëniet) me gratë e tij. Ato iu përmendën atë që dinin nga udhëzimi i Profetit (ﷺ)...”

- ndërsa ky udhëzim është udhëzimi më i mirë në fytyrën e Tokës, siç dëgjoni çdo herë, nga ne dhe nga të tjerë, në hapjen e hytbeve tona: “...udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (ﷺ)...”

“...dhe (gratë e Profetit (ﷺ)) u thanë atyre se Profeti (ﷺ) edhe agjëronte edhe e prishte (agjërimin vullnetar), edhe falej gjatë natës edhe flinte dhe gjithashtu se ai martohej me gra”.

Enesi (radijAll-llahu anhu) ka thënë:

“Kur ata i dëgjuan këto fjalë nga gratë e Profetit (ﷺ) i llogaritën të pakta!”

- domethënë: i konsideruan ibadetet e Profetit (ﷺ) të pakta, duke u bazuar në atë çfarë kishin paramenduar vetë; se Profeti (ﷺ) do të duhej patjetër të falej tërë natën, të agjëronte gjithë vitin dhe të ishte murg, që nuk i afrohet grave të tij!

Prandaj ata u befasuan nga ky realitet që s’e kishin menduar. Pasi i llogaritën të pakta ibadetet e Profetit (ﷺ), ata iu kthyen njëri-tjetrit dhe u munduan ta arsyetojnë atë “pakësi” – sipas paragjykimit të tyre – duke thënë:

“Ai është i dërguar i All-llahut! Atij All-llahu tashmë ia ka falur gjynahet e kaluara dhe të ardhme!”



Ata - All-llahu i faltë për fjalën dhe gabimin e tyre - sikur deshën të thonë:

Profeti (ﷺ) është mjaftuar me këto “pak” ibadete ngaqë All-llahu ia ka falur të gjitha gjynahet dhe, si pasojë, nuk i ka mbetur ndonjë motiv që e shtyn atë për t'i shtuar ibadetet ndaj Zotit (‘azze ue xhel-le). Ky është një gabim nga ana e tyre, pa asnjë dyshim, sepse nuk e dinin që ky devocion, të cilin e llogaritën “të paktë”, është një ibadet që s’mund ta arrijë as edhe njeriu më i devotshëm; as edhe Davudi (alejhis-salâtu ues-selâm), për të cilin, sipas transmetimeve të sakta në “Sahihun” e Buhariut, Profeti (ﷺ) ka thënë:

(كان داود أعبد البشر)

“Davudi ka qenë njeriu më i devotshëm.”

Ky grup nuk e kanë ditur se Profeti Muhamed (ﷺ), me ato adhurime që i ka bërë, ka qenë njeriu më i devotshëm (i gjitha kohërave) dhe se ibadetin e tij nuk ka mundur ta arrijë as njeriu më i devotshëm - siç përmenda më parë.

Kurse ata që e njihnin realisht ibadetin e Profetit (ﷺ)... - pra jo ky grup që nuk e njihnin ibadetin e tij, por ata që e njihnin mirë ibadetin e tij - ndienin dhembshuri për të. Sepse ata e shihnin që ai falej aq shumë, saqë iu çanin këmbët. Kjo i shtynte t'i thonë:

“O i Dërguar i All-llahut! Ty All-llahu t'i ka falur gjynahet e kaluara dhe të ardhme!”

Kanë dashur të thonë: Mëshiroje veten, o i Dërguar i All-llahut dhe kujdesu për veten tënde, sepse u lodhe dhe t'u çanë këmbët! Kurse përgjigjja e Profetit (ﷺ) ka qenë:

(أفلا أكون عبدا شكورا)

“A të mos jem rob falënderues?!”

Kjo është një kundërpërgjigje që e hedh poshtë arsyetimin e gabuar të atij grupi, të cilët, sasinë e “paktë” të ibadeteve të Profetit (ﷺ) u munduan ta arsyetojnë me faktin që All-llahu ia ka falur atij mëkatet e kaluara dhe të ardhme! Domethënë, këta nuk e dinin se Profeti është falur aq shumë, saqë i janë çarë këmbët dhe se kur i është thënë ajo që u përmend, ai është përgjigjur:

(أفلا أكون عبدا شكورا)

“A të mos jem rob falënderues?!”

Duke u nisur nga keqkuptimi i tyre se “sasia e ibadeteve të Profetit (ﷺ) ka qenë e paktë”, si dhe duke u bazuar në faktin që e dinin se “All-llahu tashmë ia ka falur të



gjitha gjynahet e kaluara dhe të ardhme”, i gjithë grupi filluan të mendojnë më vete se çdonjëri prej tyre e ka obligim ta rritë adhurimin dhe të shtojë më shumë ibadete se ato të Profetit (ﷺ), të cilat i dëgjuan, si: agjërimi, namazi, afrimi me gratë... dhe u zotuan në mes tyre si në vijim:

Njëri prej tyre tha:

- “Unë do të falem tërë natën dhe nuk do të fle!”

I dyti tha:

- “Ndërsa unë do të agjëroj gjithë vitin dhe nuk do ta ndërpres!”

Ndërsa i treti tha:

- “Unë nuk do të martohem!”

Pse? Sepse ata kanë menduar se martesë me gra të angazhon dhe të largon nga kryerja e plotë e adhurimeve ndaj All-llahut (‘azze ue xhel-le). All-llahu e di më së miri, por kam përshtypjen se ky grup kanë qenë fillestarë në Islam dhe akoma nuk i kanë kuptuar normat dhe dispozitat e Islamit. P.sh. nuk e kanë kuptuar se martesë është një ibadet, për të cilin kanë ardhur shumë hadithe. Siç është thënia e Profetit (ﷺ) në hadithin e njohur; kur vijnë disa fukarenj dhe i thonë atij:

“O i Dërguar i All-llahut! Pasanikët po marrin shpërblime me pasuritë e tyre; ata falen si ne, agjërojnë si ne, e kryejnë haxhin si ne, por ata japin lëmoshë, ndërsa ne nuk japim!”

I Dërguari (ﷺ) u ka thënë, duke i ngushëlluar:

(أفلا أدلكم على شيء إذا فعلتموه سبقتكم من قبلكم ولم يدرركم من بعدكم إلا من فعل مثلكم)

“A dëshironi t’ju mësoj një gjë, që, nëse e bëni, do t’i arrini ata që jua kanë kaluar dhe nuk do t’ju arrijnë të tjerët pas jush, përveç atyre që veprojnë si ju?”

I dërguari i fukarenjve u kthye kah shokët e tij fukarenj, i përgëzoi me këtë lajm që doli nga Profeti (ﷺ) dhe ata u gëzuan shumë. Mirëpo, kjo zgjati shumë pak! I deleguari i tyre u kthye te Profeti (ﷺ) që t’i thotë atij:

“O i Dërguar i All-llahut, pasanikëve u shkoi lajmi për atë që na the neve dhe vepruan njësoj si vepruam ne!”

Atëherë, i Dërguari (ﷺ) ka thënë:

(ذلك فضل الله يؤتيه من يشاء)

“Ajo është mirësia e All-llahut, ia dhuron kujt të dojë!”

Ky është transmetimi i imam Muslimit në “Sahih”-un e tij, kurse në një transmetim



tjetër, në një hadith tjetër, Profeti (ﷺ) u ka thënë atyre:

(إن لكم بكل تسبيحة صدقة وبكل تحميدة صدقة وبكل تكبيرة صدقة وبكل تهليلة صدقة وأمر بالمعروف صدقة ونهي عن منكر صدقة وإمطة الأذى عن الطريق صدقة ...)

“Vërtet, çdo herë kur ju thoni subhânAll-llâh është sadaka, çdo herë kur thoni el-hamdu lil-lâh është sadaka, çdo herë kur thoni All-llahu Ekber është sadaka, çdo herë kur thoni Lâ ilâhe il-lAll-llâh është sadaka, çdo urdhërim i së mirës është sadaka, çdo ndalim i së keqes është sadaka dhe çdo largim i ndonjë pengese nga rruga është sadaka...”

- ka vazhduar i Dërguari i All-llahut (ﷺ) duke përmendur shumë shembuj nga moralet e mira dhe pastaj në fund të hadithit ka thënë:

(وفي بضع أحدكم صدقة)

“...dhe marrëdhëniet bashkëshortore janë sadaka.”

Ata kanë thënë, të çuditur:

“O i Dërguari i All-llahut! A edhe kur ndonjëri prej nesh e kënaq epshin e tij paska shpërblim për të?”

I Dërguari (ﷺ) ka thënë:

(أرأيت إن وضعها في الحرام أليس يكون عليه وزر)

“Si mendon, nëse ai e kryen atë në haram, a nuk do të marrë gjynah?”

Kanë thënë: “Do të marrë, o i Dërguar i All-llahut!” I Dërguari ka thënë:

(فكذلك إذا وضعها في الحلال كان له عليها أجر)

“E pra, kështu edhe kur e kryen (epshin) në hallall, do të ketë për të shpërblim”.

Pra, ai grupi nuk ka dëgjuar hadithe si ky ose të ngjashme që nxisin për martesë, e sidomos hadithe që porosisin të kihet sabër me fëmijët dhe pasardhësit, siç është hadithi autentik i Profetit (ﷺ):

(تزوجوا الولود الودود فإنني مباه بكم الأمم يوم القيامة)

“Martohuni me gra që lindin (shumë) dhe të dashura! Se, vërtet, unë do të krenohem me ju (me numër) para ta gjithë umeteve, Ditën e Ringjalljes!”

Prandaj, ai që martohet, e mbron veten e tij dhe e mbron bashkëshorten e tij, do ketë shpërblim për këtë. Këtë gjë nuk e dinte ai grupi dhe kjo bëri që njëri prej tyre të zotohet - siç u cek më parë - me fjalët:

“... ndërsa unë nuk do të martohem me gra!”

Pas kësaj ata shkuan.



Pastaj, kur u kthye i Dërguari (ﷺ), gratë e tij i rrëfyan çfarë kishin dëgjuar prej atij grupit dhe se për çfarë ishin zotuar mes vete. Atëherë, i Dërguari (ﷺ) mbajti një fjalim në xhaminë e tij dhe tha:

(ما بال أقوام يقولون كذا وكذا وكذا)

“Si është puna e disave që thonë kështu, kështu e kështu?!”

Në këtë fjalim, i Dërguari (ﷺ) iu përmendi të pranishmëve atë që kishin thënë secili prej grupit; iu përmendi fjalët e të fundit që nuk do të martohet me gra, të dytit që ka thënë: “Unë do te agjëroj gjithë vitin dhe nuk do ta prish!” dhe tjetrit që ka thënë: “Unë do të falem tërë natën dhe nuk do të fle!”.

Mirëpo, nga edukata e Profetit (ﷺ), gjatë këshillimit, mësimdhënies dhe edukimit të njerëzve, ka qenë mbulimi i identitetit të gjynahqarit ose gabimtarit. Ai nuk i zbulonte para të tjerëve, por thoshte, siç e dëgjuat: “Si është puna e disave që thonë kështu, kështu e kështu?!”

Sepse nuk ka dobi të përmendet emri i gabimtarit, përveç në rastet kur gabimi i tij ka qenë publik para një grupi njerëzish dhe ai akoma është prezent, atëherë përmendet emri i tij. Se nëse lihet deri sa të largohet ai dhe të largohen njerëzit, humb mundësia e këshillimit të njerëzve për t’u ruajtur nga ai gabim. Pra, në raste të tilla (kur edhe gabimtari edhe njerëzit janë prezentë), duhet patjetër të paralajmërojë publikisht dhe nuk është çështja siç e ngatërrojnë disa – edhe pse dola pak nga tema – nuk është çështja siç e ngatërrojnë disa njerëz, të cilët e kanë kuptuar nevojën e urtësisë dhe butësisë gjatë urdhërimit të së mirës dhe ndalimit të së keqes, mirëpo u ka shpëtuar një gjë pa e kuptuar: se butësia, gjatë urdhërimit të së mirës dhe ndalimit të së keqes, nuk e pengon përmendjen e emrit gjatë kritikës ndaj gabimtarit, kur gabimi i tij është publik para një grupi njerëzish.

Biografite e të parëve tanë të mirë (esSelefus-Sâlih), falë dhuntisë së All-llahut, janë plot me shembuj që e mbështesin këtë. Ndërsa mua më mjafton t’jua kujtoj si shembull atë që e kanë përcjellë Buhariu dhe Muslimi në “Sahih”-ët e tyre, nën transmetimin e Abdullah ibën Umerit (radijAll-llahu anhumâ), se një ditë Xhumaje Umer ibën Hattabi (radijAll-llahu anhu) ka qenë duke mbajtur fjalim – natyrisht në xhaminë e të Dërguarit (ﷺ) – dhe në atë kohë ka hyrë njëri nga shokët e Profetit (ﷺ) – në një transmetim tregohet se ka qenë Uthman ibën Affâni – atëherë Umeri e ka ndërprerë fjalimin dhe i është drejtuar atij, që është vonuar dhe që nuk ka ardhur në kohë për ta dëgjuar fjalimin e ditës së Xhuma. Ndërsa ai është përgjigjur:



“O Prijësi i Besimtarëve! Unë, sa e dëgjova ezanin, menjëherë mora avdes dhe erdha në xhami”.

Umeri i tha atij, duke iu kundërpërgjigjur me një pyetje qortimi:

“Edhe avdes, a?! Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut (ﷺ) duke thënë:

(من أتى منكم الجمعة فليغتسل)

“Kush shkon prej jush në Xhuma, le të lahet!”

Argumenti në këtë ndodhi është se ai e qortoi Uthman ibën Affanin haptazi, në prani të të gjithëve, për mosardhjen në kohë për dëgjimin e hytbes së Xhumasë.

Të kthehemi aty ku e kishim fjalën, se mësimdhënia dhe këshillimi ngrihen mbi parimin e mbulimit të identiteteve të njerëzve, përveç nëse e kërkon nevoja. Sipas këtij parimi veprimi i Dërguarit (ﷺ) gjatë fjalimit të tij në lidhje me këtë grup. Ai foli për ta në mënyrë indirekte, duke mos e përmendur asnjërin prej tyre me emër: “Si është puna e disave që thonë kështu, kështu e kështu...”

Ku është argumenti ynë? Argumenti është në vazhdim të hadithit; Profeti (ﷺ) thotë:

(أما إني...)

“Me të vërtetë, unë...”

- dhe këtu vjen kundërpërgjigjja ndaj atyre që e arsyetonin ibadetin e tij “të paktë”, me pretekstin se All-llahu ia ka falur gjynahet e kaluara dhe të ardhme -

(أما إني أحشاكم لله وأتقاكم لله أما إني أصوم وأفطر وأقوم الليل وأنا وأتزوج النساء فمن رغب عن سنتي فليس مني)

“Me të vërtetë, unë jam njeriu që më së shumti i frikësohem All-llahut dhe që më së shumti i ruhem (dënimin; zemërimin të) All-llahut! Me të vërtetë, unë edhe agjëroj edhe e prish...”

- d.m.th. nuk e agjëroj tërë vitin -

“... falem natën dhe fle...”

- d.m.th. nuk e gdhij gjithë natën (me namaz), siç bëjnë disa ekstremistë, adhurues e asketë, të cilët duan ta kalojnë ibadetin e Profetit (ﷺ), duke e çuar tërë natën me namaz, ibadet dhe lexim të Kuranit. Kjo nuk është në pajtim me udhëzimin e të Dërguarit (ﷺ). Për këtë arsye, siç transmetohet në “Sahihun” e Muslimit, zonja Aisha ka thënë:

“Profeti (ﷺ) asnjëherë nuk është falur tërë natën deri në mëngjes.”



Pra, i Dërguari (ﷺ), duke i kujtuar ata se Sheriati është mesatar; se ibadeti është mesatar dhe se në të nuk ka as teprim e as shpërfillje, ka thënë:

“Me të vërtetë, unë jam njeriu që më së shumti i frikësohem All-llahut (me përulje dhe nënshtrim) dhe që më së shumti i ruhem All-llahut (me bindje dhe adhurim)! Unë agjëroj dhe e prish, falem natën dhe fle si dhe martohem me gra! Kush e urren Sunetin tim (nuk e pëlqen rrugën time), nuk është me mua!”

Domethënë, Suneti e Profetit (ﷺ) është ai, të cilit çdo mysliman e ka obligim t'i përmbahet, në çdo çështje të Islamit që na është transmetuar.

Unë ju siguroj se Davudi ('alejhis-salâtu ues-selâm), për të cilin e dëgjuat më herët dëshminë e Profetit (ﷺ) se ka qenë njeriu më ibadetçi, po të jetonte pas Dërgesës së të Dërguarit Muhamed (ﷺ), me këtë Islam të kompletuar e të plotë, nuk do të kishte mundur t'i realizojë të gjitha ibadetet që i ka bërë i Dërguari Muhamed (ﷺ), me fjalët, veprat ose miratimet e tij.

Për këto arsye; pasi e ka kompletuar All-llahu Fenë, me dërgimin e Profetit tonë (ﷺ) me këtë Islam të plotë, dhe pasi e kuptuam se Profeti (ﷺ) është njeriu më ibadetçi, më i devotshëm dhe që më së shumti i frikësohet All-llahut, muslimanit nuk i ka mbetur asnjëfarë mundësie që të korrigojë ose të zbulojë ndonjë adhurim. S'ka mbetur gjë, veçse të ndjekim shembullin e të Dërguarit (ﷺ), duke qenë të bindur se nuk mund t'i afrohem adhurimeve të Profetit (ﷺ), veçse ndonjëherë dhe shumë shkurt. Përndryshe jemi plotësisht të paaftë t'i ndjekim dhe t'i përcjellim të gjitha hapat e të Dërguarit në ibadetet e tij. Kjo është një gjë e pamundur për cilindo individ, pas Profetit (ﷺ).

Prandaj, nuk mbetet para nesh gjë tjetër veçse të përiqemi me të gjitha forcat që t'i arrijmë dy gjëra:

- **E para:** ta mësojmë Sunetin e Profetit (ﷺ) në çdo çështje të Islamit që na është transmetuar, qoftë në akide (besim), qoftë në veprat e adhurimit, qoftë në sjellje dhe etikë. Edhe pse ne, siç ju thashë, nuk kemi mundësi ndryshe, përveçse të mundohemi ta imitojmë atë. Siç është thënë (në një poezi):

*“Nëse nuk mund të jeni si ata, imitoni,  
se, vërtet, te imitimi i fisnikëve është suksesi!”*

Neve nuk na takon ta imitojmë asnjë njeri, përveç Profetit (ﷺ), sepse ai, pa asnjë kundërshtim, është njeriu më i përsosur. Dhe kushdo që e imiton atë, merr thjesht veç një grusht nga deti i ibadeteve të tij.



Kjo ishte çështja e parë; ta mësojmë Sunetin e të Dërguarit (ﷺ) me kuptimin e gjerë të fjalës “Sunet”... – ndërsa këtu patjetër na duhet një parantezë (sqarim anësor):  
Më herët e dëgjuat fjalën e Profetit (ﷺ), të përcjellë nga Enesi, lidhur me atë grupin:

فمن رغب عن سنتي فليس مني

“Kush nuk e pëlqen Sunetin tim, nuk është me mua!”

I Dërguari ynë (ﷺ), në këtë hadith të rëndësishëm, me shprehjen: “Ai që nuk e pëlqen Sunetin tim”, nuk ka dashur të thotë: ‘ai që i lë sunetet e rregullta (namazet vullnetare) nuk është me mua’. Nuk është ky kuptimi i hadithit. Kuptimi i thënies: “Ai që e nuk e pëlqen Sunetin tim...” është: ‘Ai që nuk e pëlqen rrugën time, sjelljen time dhe metodologjinë time në tërë jetën e tij fetare...’ – Ky është ai që nuk është me Profetin (ﷺ). Dhe njerëzit dallojnë te kjo gjë, varësisht nga ajo se sa janë larg ndjekjes së Profetit (ﷺ).

Pra, fjala “Sunet” ka dy përdorime:

- I pari me kuptimin leksikor shariatik, sipas të cilit Suneti është rruga (feja) e të Dërguarit (ﷺ) dhe e atyre që e kanë pasuar.
- I dyti me kuptimin që e përdorin dijetarët e Fikhut (Jurisprudencës Islame), të cilët i ndajnë ibadetet në: farze (të obligueshme) dhe sunete (jo të obligueshme). Dhe ju e dini definicionin e farzit dhe definicionin e sunetit. Sipas terminologjisë së kësaj shkence, “sunet” është: çdo ibadet të cilin, kush e bën shpërblehet dhe kush e lë nuk dënohet.

Kurse ai që e lë Sunetin e të Dërguarit (ﷺ) sipas kuptimit të parë – d.m.th. e lë rrugën dhe metodologjinë e tij – ky do të jetë në devijim. Se sa i madh ose i vogël është devijimi i tij, varet nga ajo se sa qëndron larg ose afër ndjekjes së Sunetit të të Dërguarit (ﷺ), siç e thamë më herët.

Për këtë shkak, e kemi obligim ta mësojmë Sunetin së pari, pastaj, së dyti, ta zbatojmë atë aq sa mundemi. E këtu (gjatë praktikës) do ta shohim se s’kemi nevojë aspak të korrigojmë/plotësojmë diçka, ose të nisim ndonjë bidat “të mirë” në Islam e të pretendojmë se s’ka gjë të keqe; sepse ne do ta kuptojmë se jemi të dobët e të paafte që ta ndjekim Profetin tonë fisnik në të gjitha ibadetet që i ka sjell, pavarësisht a bëhet fjalë për lutje, apo dhikre, apo namaz... Pra, neve na mjafton veç ta ndjekim atë, sa të kemi mundësi.



Këtu kam kënaqësi t'ju kujtoj një ndodhi, të cilën e ka transmetuar Buhariu në "Sahihun" e tij, që ta njihni vlerën a ajetit që e përmendëm më herët:

اليوم أكملت لكم دينكم وأتممت عليكم نعمتي ورضيت لكم الإسلام دينا  
 "Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe Jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj." [El-Mâide, 3]

Buhariu ka transmetuar se një rabin çifut ka shkuar tek Umer ibën Hattabi, në kohën e kalifatit të tij dhe i ka thënë:

"O Prijësi i Besimtarëve! Në Librin e All-llahut gjendet një ajet, që, po të na kishte zbritur neve çifutëve, ditën e zbritjes së tij do ta merrnim për festë!"

Umeri - All-llahu qoftë i kënaqur me të - ka thënë:

"Cili është ai ajet?"

Ai ia ka përmendur këtë ajet:

"Sot jua përsosa fenë tuaj..." - deri në fund.

Umeri i ka thënë:

"Po ai vërtetë ka zbritur në ditë feste: në ditë Xhumaje, kur i Dërguari (ﷺ) ishte në Arafat".

Domethënë: në haxhin e lamtumirës. Pra, ky ajet ka zbritur në një ditë shumë madhështore, ditë kur janë bashkuar dy mirësi dhe dy festa: Festa e Xhumasë dhe ajo e Arafatit. Umeri sikur ka dashur t'i thotë rabinut: Mos u shqetëso ti, se ky ajet ka zbritur në ditë feste: Festën e Xhumasë dhe Festën e Arafatit.

Përse ky çifut ka thënë: "...po të na kishte zbritur neve çifutëve, ditën e zbritjes së tij do ta merrnim për festë"? - Sepse ai e pati kuptuar madhësitinë e kësaj dhuntie, të cilën All-llahu (tebârake ue te'âlâ) ia ka dhuruar robërve të Vet.

Kurse ne myslimanët sot - që është për të ardhur shumë keq - nuk e kemi vlerësuar këtë dhunti ashtu si duhet. Prandaj gjen shumë njerëz në të kaluarën, te gjeneratat e mëvonshme, që i kanë angazhuar myslimanët me shumë lloje të namazeve, dhikreve dhe lutjeve, të cilat nuk i ka sjell Profeti (ﷺ).

Ato ibadete që i ka sjell Profeti (ﷺ), siç e cekëm, janë më se të mjaftueshme, madje edhe e kalojnë takatin tonë si njerëz. Çdonjëri prej nesh merr nga këto ibadete veç aq sa ka mundësi dhe aq sa i përshtatet fuqisë dhe takatit të tij.



Nëse e kuptuam këtë realitet, duhet ta dimë, gjithashtu, se ekzistojnë disa përpjekje për t'i futur njeriut dyshime dhe turbullime, me qëllim që t'i bllokohet rruga dhe të mos mbesë në këtë ndjekje të pastër të Profetit (ﷺ), të cilën e përmenda në fillim të këtij fjalimi, e ajo ishte:

‘Ashtu siç pohojmë se All-llahu është Një dhe i Vetmi që duhet adhuruar, duhet të pohojmë edhe se i Dërguari (ﷺ) është një dhe i vetmi që duhet ndjekur.’

Gjatë rrugës së realizimit të kësaj të dytës, mund të paraqiten disa hutime, përmes të cilave, disa njerëz i frymëzojnë muslimanët që të ndjekin edhe gjëra që nuk i ka sjell i Dërguari (ﷺ).

Çfarë do të thotë kjo? Se ata e kanë hapur derën që t'i bashkëngjisim ortakë të Dërguarit (ﷺ) që, krahas tij, t'i ndjekim dhe t'i pasojmë edhe ata. Kjo përbën shkelje në Shehadetin e Dytë: “Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij”.

Ata lidhen për disa shubuhate (hutime), kurse unë do të përmend tani vetëm një nga ato – dhe do t'i përgjigjem – që me të të krahasohen edhe hutime të tjera, që mund t'i keni dëgjuar. Mos e lëkundni këtë shtyllë të dytë të të dy dëshmive: “Muhammedun abduHu we rasuluH!”

Për këtë hutim (që do ta përmendim), ata “mbështeten” në një hadith, i cili është përcjellë në “Sahihun” e Muslimit, në “Musnedin” e imam Ahmedit dhe në librat e tjerë të Sunetit dhe që e transmeton Xherir ibën Abdil-lâh el-Bexhelij (radijAll-llahu anhu). Në këtë hadith Profeti (ﷺ) ka thënë:

(من سن في الإسلام سنة حسنة فله أجرها وأجر من عمل بها إلى يوم القيامة دون أن ينقص من أجورهم شيء...)

“Kush nis në Islam një nismë (shembull) të mirë, ai e ka shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që e veprojnë atë deri në Ditën e Ringjalljes, pa iu pakësuar atyre aspak shpërblimi...” - hadithi vazhdon.[1]

Ja si e shpjegojnë hadithin këta (që duan t'i hutojnë njerëzit):

“Kush nis në Islam” - domethënë: “Kush shpik në Islam”;

“një nismë të mirë” - domethënë: “një bidat të mirë”;

“ai e ka shpërblimin e saj...” - e kështu deri në fund të hadithit.

Ajo që dua ta sqaroj tani, në këtë çast të bekuar inshaAll-llâh, është kjo: Nuk është kuptimi i këtij hadithi ashtu si pretendojnë këta!

[1] Përcjellë nga Muslimi dhe të tjerë.



Hadithi nuk e ka kuptimin: “Kush shpik në Islam një bidat të mirë”, por kuptimi i tij është: Kush e inicion dhe i çel rrugë një zakoni të mirë, që është i ligjshëm dhe i njohur në Islam – e jo i shpikur si pretendojnë këta – ai e ka shpërblimin për përtëritjen e këtij shembulli të mirë dhe i meriton shpërblimet e atyre që e ndjekin atë deri në Ditën e Ringjalljes, pa iu pakësuar aspak atyre shpërblimi.

Argument për këtë që e themi janë disa çështje:

### **E para: Sebepe që e ka shtyrë Profetin (ﷺ) ta thotë këtë hadith.**

Ne kemi mësuar nga dijetarët tanë, veçanërisht nga dijetarët e Tefsirit (diturisë që merret me shpjegimin e Kuranit), se kush e ka mësuar shkakun e zbritjes së ajetit, e ka mësuar gjysmën e kuptimit të tij dhe i mbetet ta mësojë gjysmën tjetër, që është gjuha arabe dhe letërsia e saj.

Nga kjo shprehje e tyre kam nxjerr si përfundim se, kur dikush e mëson shkakun pse është thënë një hadith, atij i lehtësohet ta kuptojë gjysmën e domethënies dhe i mbetet vetëm ta kuptojë edhe gjysmën tjetër.

Ne do ta përmendim tani sebepe se pse është thënë ky hadith, që ta vërtetoni me mua faktin se interpretimi i tyre i hadithit, në atë mënyrë që e përmendëm më herët, është një nga pavërtetësitë më të mëdha; dhe se nuk i ka hije dikujt që s’flet arabisht ta shpjegojë ashtu, e lëre më atij që flet arabisht! E lëre më ky kuptim (i shtrembër) t’i atribuohet Profetit (ﷺ), gojëtarit më të qartë në mesin e atyre që e shqiptojnë Dâd-in[1].

### **Shkak i thënies së hadithit**

Xheriri (radijAll-llahu anhu) ka thënë[2]:

“Ishim të ulur te Profeti (ﷺ) në fillim të ditës dhe i erdhën disa njerëz (arabë të shkretëtirës), të zbathur, të rreckosur, me disa veshje prej leshi (të cilat i shpojnë dhe futen në to) dhe të ngjeshur me shpata (në brez), përgjithësisht nga fisi Mudar, bile të gjithë nga fisi Mudar. Kur e pa varfërinë e tyre, të Dërguarit të All-llahut (ﷺ) iu zbeh fytyra.”

[1] Domethënë ata që e flasin arabishten, sepse “Dâd”-i ( ض ) është një prej shkronjave të veçanta të arabishtes (përkthyesi).

[2] Duke qenë se shejh Albani (All-llahu e mëshiroftë) e ka cituar këtë hadith përmendësh, në vend ajetit të sures en-Nisa’ e ka përmendur gabimisht një ajet tjetër, i cili po ashtu nxit për sadaka. Kurse unë e kam përcjell ajetin e duhur, siç qëndron te Muslimi dhe të tjerët dhe kam vendosur që në tekst t’i përmbahem transmetimit të Imam Muslimit (përkthyesi).



- D.m.th.: i ndryshuan tiparet e fytyrës nga dhembshuria dhe keqardhja.

"Hyri (në shtëpi) dhe doli. Pastaj e urdhëroi Bilalin (për ezan) dhe Bilali e thirri ezanin dhe më pas ikametin. Pasi u fal, mbajti një fjalim dhe tha:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً  
وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

"O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.

Frikësojuni All-llahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, All-llahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju." [En-Nisâ, 1]

Edhe ajetin që gjendet te surja el-Hashr:

اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَا قَدَّمَتْ لِغَدٍ وَاتَّقُوا اللَّهَ

"(O besimtarë) frikësojuni All-llahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen (botën tjetër)! Ruajuni All-llahut, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!" [El-Hashr, 18]

Pastaj Profeti (ﷺ) ka thënë:

«تَصَدَّقَ رَجُلٌ مِنْ دِينَارِهِ، مِنْ دِرْهَمِهِ، مِنْ تَوْبِهِ، مِنْ صَاعِ بُرِّهِ، مِنْ صَاعِ تَمْرِهِ - حَتَّى قَالَ - وَلَوْ بِشِقِّ تَمْرَةٍ»

"Le të nxjerrë çdonjëri sadaka (lëmoshë); njëri nga dërhemi i tij, tjetri nga dinari i tij, tjetri nga rrobat e tij, tjetri nga ena e grurit të tij..." - vazhdoi deri kur tha:

"...jepni qoftë edhe një gjysmë hurme!"

Nuk pritën shokët e Profetit (ﷺ), por u ngritën menjëherë pas kësaj ligjërate të bekuar. Të gjithë shkuan në shtëpitë e tyre dhe u kthyen duke mbajtur me fundit e rrobave të tyre veshje, dinarë e dërhemë, aq sa kanë pasur mundësi.

Xheriri (radijAll-llahu anhu) ka thënë në vazhdim:

"Atëherë, erdhi njëri nga Ensarët duke mbajtur një thes aq të rëndë sa gati nuk ia mbante krahu, bile nuk ia mbajti... Pas kësaj, njerëzit filluan një pas një (të sjellin gjëra), deri sa i pashë dy grumbuj të mëdha me ushqime dhe veshje dhe e pashë fytyrën e të Dërguarit të All-llahut (ﷺ) duke ndritur, sikur të ishte e larë me ar!

I ndriçonte fytyra nga gëzimi që sahabët iu përgjigjen nxitjes së tij për sadaka. E, në këtë rast, i Dërguari i All-llahut (ﷺ) ka thënë:

"من سن في الإسلام سنة حسنة فله أجرها وأجر من عمل بها إلى يوم القيامة دون أن ينقص من أجورهم شيء"

"Kush nis në Islam një nismë (shembull, zakon, rrugë) të mirë, ai e ka shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që e veprojnë atë deri në Ditën e Ringjalljes, pa u pakësuar aspak shpërblimi i tyre..." - deri në fund të hadithit. [Muslim, 1017]



**Tani pyesim:** Si mund ta interpretojmë këtë hadith në atë mënyrë që e përmendëm, kur ajo nuk përputhet, madje bie në kundërshtim të plotë, me atë që ndodhi në prani të Profetit (ﷺ); me lëmoshën?!

Tani që e dëgjuat shkakun e thënies së hadithit, e patë që aty nuk ka ndodhur kurrfarë bidati; kurrfarë veprë e re dhe e panjohur tek ata. S'ka ndodhur fare diçka e tillë! S'ka ndodhur asgjë, përveç sadakasë, siç e dëgjuat. I Dërguari (ﷺ) u lexoi shokëve të tij një Ajet fisnik, i cili urdhëron për sadaka, pastaj e përforcoi atë me fjalët e tij:

«تَصَدَّقَ رَجُلٌ مِنْ دِينَارِهِ، مِنْ دَرَاهِمِهِ، مِنْ تَوْبِهِ، مِنْ صَاعِ بُرِّهِ، مِنْ صَاعِ تَمْرِهِ»

“Le të nxjerrë çdonjëri sadaka (lëmoshë); njëri nga dërhemi i tij, tjetri nga dinari i tij, tjetri nga rrobat e tij, tjetri nga ena e grurit të tij...”

Si përfundim, e gjithë kjo dëshmon se në këtë tregim nuk ka asnjë bidat, por ka vetëm një Sunet të ligjshëm dhe ajo është: Sadakaja. Aty thjesht iu dhurua lëmoshë atyre të varfërve që erdhën si mysafirë te shokët e Profetit (ﷺ). Me këtë rast, i Dërguari (ﷺ) ka thënë: “Kush nis në Islam një nismë të mirë...”

Këtë hadith e përmenda shkurtimisht, kurse ai vazhdon:

“...ومن سن في الإسلام سنة سيئة فعليه وزرها ووزر من عمل بها إلى يوم القيامة دون أن ينقص من أوزارهم شيء”

“...ndërsa kush nis në Islam një nismë të keqe, ai e ka gjynahun e saj dhe gjynahun e atyre që e veprojnë atë deri në Ditën e Ringjalljes, pa u pakësuar aspak gjynahu i tyre.”

Pra, nisma është dylojëshe: nismë e mirë dhe nismë e keqe. Ai që e ngjall një nismë (zakon) të mirë, do ta ketë shpërblimin e tij dhe shpërblimin e atyre që e veprojnë atë deri në Ditën e Ringjalljes, kurse ai që e ngjall një zakon të keq, do ta ketë gjynahun e tij dhe gjynahun e atyre që e ndjekin deri në Ditën e Ringjalljes.

Pra çështja e parë thotë se në këtë tregim nuk përmendet asgjë që mund të cilësohet si bidat dhe se gjëja e vetme që përmendet aty është: nxitja e Profetit (ﷺ) për lëmoshë.

## Tani do të përmendim çështjen e dytë:

Le t'i mbyllim sytë lidhur me sebebën e thënies së hadithit... – dhe sa të shumtë janë ata që gjatë studimit të Hadithit Profetik mjaftohen me librat e shkurtra të haditheve dhe shumë pak prej tyre që i kthehen librave burimorë dhe bazë, që t'i gjejnë shkaqet e thënies së haditheve, si rasti i këtij hadithi.



Le t'i mbyllim sytë tani lidhur me shkakun e ngjarjes së hadithit dhe të ndalemi te teksti i tij: “Kush nis në Islam një nismë të mirë...”

“Kush nis” – domethënë: kush i çel rrugë.

Tani ta parashtrojmë pyetjen:

Cila është metoda për njohjen e nismës së mirë, që ta ndjekim dhe të kapemi për të? Dhe cila është mënyra për njohjen e nismës së keqe, që t'i shmangemi dhe të qëndrojmë larg saj?

A ekziston rrugë tjetër për këtë, përveç rrugës që e ka sjellë i Dërguari (ﷺ) – Kuranit dhe Sunetit?

Përgjigjja është: Nuk ekziston asgjë tjetër! Sepse i Dërguari (ﷺ) ka thënë:

«تركت فيكم أمرين لن تضلوا ما إن تمسكتم بهما كتاب الله وسنتي ولن يتفرقا حتى يردا عليّ الحوض»  
 “Kam lënë në mesin tuaj dy çështje; përderisa kapeni për to, nuk do të devijoni:  
 Libri i All-llahut dhe Suneti im. Këto të dyja nuk do të ndahen nga njëra-tjetra,  
 deri kur të më vijnë te Haudi”.

Kështu që kriteri ynë, përmes të cilit e njohim nismën e mirë dhe nismën e keqe, është vetëm Sheriati – Libri dhe Suneti.

Ky është një realitet, të cilin nuk mund ta vërë në diskutim ose polemikë asnjë dijetar! Asnjë dijetar i vërtetë, dituria e të cilit buron nga Libri i All-llahut dhe Hadithi i të Dërguarit (ﷺ).

Kjo është kështu, sepse një nga çështjet që lthtarët e Sunetit (Ehlu-Sunneh) pajtohen unanimit, kurse Mu'tezilitë e kundërshtojnë, është ajo se “Rruga e vetme, përmes së cilës i mësojmë dispozitat ligjore dhe e kuptojmë se çfarë është e mirë dhe çfarë e keqe, është Sheriati”.

Pra për këtë çështje Ehlu Suneti janë të një mendimi unanimit, kurse Mu'tezilitë e kanë kundërshtuar. Mu'tezilitë kanë thënë: “E mira është ajo që logjika e llogarit të mirë, ndërsa e keqja është ajo që logjika e llogarit të keqe”. Ehlu Suneti i kanë kundërshtuar dhe kanë thënë: “Jo! E mira është ajo që Sheriati e llogarit të mirë dhe e keqja është ajo që Sheriati e llogarit të keqe”.

**Tani, kur vijmë te ky hadith: “Kush nis në Islam një nismë të mirë...” – pyesim:**

Cila qenka rruga për ta njohur nismën e mirë: logjika apo Sheriati? Përgjigjja, në mënyrë të prerë, është: Sheriati. Atëherë, edhe nga ana e kundërt: “Kush nis në Islam një nismë të keqe...” – pyesim: Nga ta dimë se kjo nismë është e keqe? Nga logjika apo Sheriati? Përgjigjja gjithashtu është: Sheriati.



Prandaj, kur dikush pretendon se një nismë e caktuar është nismë e mirë, ne i themi:

**“Nëse është e vërtetë ajo që thoni, atëherë sillni provën tuaj!”**

Nëse e sjell këtë provë, atëherë na ka obliguar me Sheriat që ta ndjekim. Por [jo] nëse thotë, si shumë njerëz që thonë: “O vëlla! Kjo çështje është e lehtë...”, “Kjo është thjesht shtesë dhe shtesa është mirë...” ose fjalë të ngjashme që dalin nga njerëzit e thjeshtë, e jo nga njerëzit e dijes. Fjalët e njerëzve të dijes janë ato që i dëgjuat.

Pra, ta gjykosësh të mirën dhe të keqen me logjikë është pjesë e ideologjisë së Mu'tezilive, kurse Ehlul Suneti thonë se vlerësimi i së mirës dhe i së keqes është punë e Sheriatit. Kështu që ne jemi me Sheriatin në vlerësimin e së mirës dhe së keqes.

Kjo është ajo çfarë desha: t'i largojmë hutimet dhe dyshimet lidhur me këtë hadith, nëpërmjet këtyre dy rrugëve.

Rruga e parë ishte gjetja e sebebëve të hadithit – sepse kjo na e vërteton faktin që aty nuk ka ndodhur kurrfarë bidati dhe se nuk është e mundur që i Dërguari (ﷺ), me thënien: “Kush nis në Islam një nismë të mirë...”, të ketë pasur për qëllim: ‘Kush shpik në Islam një bidat të mirë!’, sepse këto fjalë i ka thënë me rastin e sadakasë, e cila nuk është bidat.

Thënia e tyre është kontradiktore dhe, siç thashë më herët, do të ishte turp për atë që nuk e flet arabishten ta shpjegojë kështu, e si mund që ta thotë atë Profeti ynë (ﷺ), prijësi i atyre që e shqiptojnë shkronjën Dâd?

Mjaftohemi me kaq.

Çdo lavd i takon All-llahut, Zotit të botëve.

